

PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

Newsletter

ÇËSHTJET KRYESORE

- Fq. 1 - Një epokë përfundon, një e re do të fillojë!
- Fq. 3 - Një hap i madh drejt monitorimit të jetës së egër në Kosovë
- Fq. 4 - Kur gjuetarët bashkojnë forcat për të shpëtuar një grabitqar kryesor, në krye të zinxhirit ushqimor
- Fq. 5 - Si u fut rrëqebulli i Koritnikut në jetën time të përditshme
- Fq. 6 - Duke festuar për macen tonë të madhe të rrezikuar në Ditën Ndërkombëtare të Rrëqebullit
- Fq. 7 - Moratoriumi i ri i gjuetisë në Shqipëri: do të jetë i vërtetë apo do të mbetet sërish në letër?



© LL/BLRP

NJË EPOKË PËRFUNDON, NJË E RE DO TË FILLOJË!

Nga Manuela von Arx

Kanë kaluar 16 vite që nga fillimi i Programit për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit, një projekt i përbashkët ndërkufitar që ka si synim ruajtjen e rrëqebullit të Ballkanit duke përdorur një qasje integruese. Çfarë kemi arritur? Epo, rrëqebulli i Ballkanit ekziston ende dhe ne dimë shumë më tepër për nevojat e përhapjes, ekologjisë dhe mbrojtjes së tij. Nëpërmjet këtij programi, u rritën kapacitetet personale në fushën e kërkimit shkencor si dhe u konsolidua rrjeti i organizatave jo qeveritare rajonale. Gjithashtu, krahas njohjes së rrëqebullit të Ballkanit, u siguroa dhe rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit lokal në lidhje me statusin kritik të këtij nënloji të rrezikuar. Ne lobuam me sukses për përfshirjen e rrëqebullit të Ballkanit në Shtojcën II të Konventës së Bernës dhe kontribuam në përcaktimin e zonave të reja të mbrojtura të rëndësishme për rrëqebullin. Për më tepër, u theksua rëndësia e bashkëpunimit me banorët lokal dhe grupet përkatëse të interesit si gjuetarët dhe për të zbatuar aktivitete të përbashkëta, të cilat dhanë rezultate.

Çfarë nuk arritëm? Megjithëse u pa një rritje e lehtë e numrit të individëve në zonën kryesore të popullatës, Parkun Kombëtar të Mavrovës në Maqedoninë e Veriut, dhe një zgjerim në zonat më në jug, madhësia e popullatës mbetet shumë e ulët - më pak se 50 individë të maturuar dhe kështu larg vlerës së pragut për t'i shpëtuar statusit të rrezikuar në mënyrë kritike.



Kërcënimet si vrasja e paligjshme e rrëqebullit ose preut të tij kryesor (kaprolli dhe dhia e egër) po ndodhin ende; zhvillimet infrastrukturore po shkatërrojnë habitatin e përshtatshëm të rrëqebullit, sistemet e gjuetisë dhe pylltarisë nuk përmbushin standardet e qëndrueshmërisë, si dhe zbatimi i ligjit është përgjithësisht i dobët.

Megjithatë, ne ende nuk jemi dorëzuar dhe besojmë se rrëqebulli i Ballkanit meriton të gjitha përpjekjet tona për t'u shpëtuar nga zhdukja. Shpresojmë të kemi në krah shoqërinë civile, grupet përkatëse të interesit dhe autoritetet për ruajtjen e këtij lloji. Ne do të vazhdojmë të punojmë në drejtim të reduktimit të kërcënimeve për rrëqebullin e Ballkanit dhe do të hulumtojmë mbi pasojat e numrit të vogël të popullatës dhe masat për zvogëlimin e tyre.

Fatkeqësisht, duhet t'i themi lamtumirë një partneri, i cili ishte me ne që nga fillimi i Programit për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit, në 2006, e që na mbështeti gjatë gjithë këtyre viteve duke kontribuar kështu në shumë zhvillime pozitive në drejtime të ndryshme: Një falenderim i madh i shkon Fondacionit MAVA, për besimin e dhënë në Programin e Rimëkëmbjes së Rrëqebullit të Ballkanit dhe ekipin tonë! Është e papërshtueshme mbështetja që kemi patur për një kohë kaq të gjatë dhe jemi shumë mirënjohës dhe të lumtur për këtë besim. MAVA na ndihmoi gjithashtu në sigurimin e një donatori të ri i cili po mbështet misionin tonë në favor të rimëkëmbjes së popullatës së rrëqebullit të Ballkanit. Faleminderit!



NJË HAP I MADH DREJT MONITORIMIT TË JETËS SË EGËR NË KOSOVË

Nga Bardh Sanaja

Monitorimi sistematik i jetës së egër është i rëndësishëm për të vlerësuar statusin e tyre të ruajtjes dhe për të marrë masa për mbrojtjen e tyre. Së fundmi, në Kosovë ka patur avancime në këtë drejtim, me nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit (MoU) ndërmjet organizatës ERA dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI-së) për të zhvilluar një koncept të monitorimit të jetës së egër duke përfshirë kryesisht gjitarët si ariu i murrmë, ujku, rrëqebulli i Ballkanit dhe macja e egër.

Gjatë viteve të fundit, ERA, në kuadër të Programit për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit (BLRP), ka bërë hapa të konsiderueshëm drejt monitorimit të rrëqebullit të Ballkanit, duke përmirësuar tashmë njohuritë mbi trendin e popullatës, pranisë dhe shpërndarjes së llojit. Ndërkohë, llojet e tjera mbeten të panjohura. Koncepti i skemës së monitorimit që u përdor për rrëqebullin e Ballkanit është i mirëpërcaktuar dhe mund të zgjerohet për të përfshirë lloje të tjera. Për këtë ERA së bashku me MMPHI kanë rënë dakord për krijimin e një grupi pune i cili do të marrë përsipër zhvillimin e konceptit të monitorimit për kafshët e egra.

Gjatë BLRP, bashkëpunimi ndërinstitucional në Kosovë është rritur ndjeshëm. Fazat e monitorimit kërkuar mbështetjen e autoriteteve lokale, administratës së parkut kombëtar dhe ministrive. Ky proces tani do të jetë i ndërsjellë, i cili nga ana tjetër do të përmirësojë më tej bashkëpunimin. Përveç kësaj, të dhënat e gjeneruara do të mbështesin Kosovën në arritjen e standardeve për ruajtje dhe monitorim të kërkuar nga Konventa e Bernës dhe Direktiva e Habitaveve e BE.



KUR GJUEJARËT BASHKOJNË FORCAT PËR TË SHPËTUAR NJË GRABITQAR KRYESOR, NË KRYE TË ZINXHIRIT USHQIMOR

Nga Aleksandar Pavlov

E izoluar në Gadishullin e Ballkanit, një mace indigjene dhe e rrezikuar në mënyrë kritike ka një tokë të kufizuar për ta quajtur shtëpinë e saj. Këto zona me habitat të favorshëm, të gjendura në zona të mbrojtura ose pranë rezervateve të gjuetisë, nuk vuajnë nga presioni i rëndë njerëzor, duke i dhënë një shans përpjekjeve për rimëkëmbjen e popullatës së rrëqebullit të Ballkanit.

Bashkëpunimi me gjuetarët përfshin sensibilizimin e tyre për rëndësinë e grabitqarëve që janë në majë të zinxhirit ushqimor, në një rezervat gjuetie, duke thyer kështu mitet dhe kapërcyer paragjykimet për praninë e rrëqebullit dhe ndikimin e tij tek llojet objekt-gjuetie. Nëpërmjet monitorimit të përbashkët duke përdorur kamera kurth, ne i ndihmojmë ata të kuptojnë problemin dhe në të njëjtën kohë krijojmë një ndjenjë të përbashkët mbi procesin. Tani gjuetarët janë ata që janë përgjegjës për mbrojtjen e rrëqebullit të Ballkanit në habitatin e tyre! Por një partneritet i tillë është një rrugë e dyanshme. Vitet e punës së përbashkët na kanë ofruar një kuptim të thellë të paradigmes së gjuetarit-qëndrimet e tyre, vlerat që ata mbajnë, praktikat e zakonshme, por edhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat përballen. E gjithë kjo është vërtet e dobishme për punën tonë, pasi nxit besimin e ndërsjellë dhe krijon miqësi me gjuetarët, të cilët luajnë një rol jetësor në historinë e rrëqebullit. Dhe, më e rëndësishmja, rrëqebulli tani shihet në një këndvështrim tjetër më të favorshëm.

Monitorimi i përbashkët i këtij viti paraqet një vazhdimësi të bashkëpunimit të iniciuar në vitin 2017 ndërmjet MES dhe katër shoqatave të gjuetisë (SHGj) që menaxhojnë rezervatet e gjuetisë ku është i pranishëm rrëqebulli: Sokol-Z HS (Kichevo), Piton HS (Ohër), HS Malesija (Strugë) dhe Cern Kamen HS (Vevchani). Bashkimi i një SHGj tjetër nga zona e Kichevos, Eko Fazan, ishte një nxitje e mirëpritur për përpjekjet monitoruese të vitit 2022.



© MES/BLRP

Para fillimit të monitorimit aktual, rojtarëve të gjahut dhe gjuetarëve nga të pesë SHGj-së iu mbajt një prezantim mbi biologjinë dhe ekologjinë e rrëqebullit të Ballkanit, duke shpjeguar metodologjinë e punës në terren. Përpos kësaj, çdo shoqate të gjuetisë iu dhurua një kamera kurth dhe trajnim bazë nga ekipi i rrëqebullit të MES për të zhvilluar një monitorim brenda rezervateve të tyre. Të gjitha kamerat kurth u vendosën në fillim të shkurtit dhe qëndruan aktive deri në fund të majit.

Rezultatet janë inkurajuese! Tre nga pesë shoqatat e gjuetisë arritën të kapnin një individ rrëqebulli. Janë marrë gjithsej 50 imazhe të rrëqebullit të Ballkanit. Surpriza më e madhe për të gjithë të përfshirët ishte një video e një rrëqebulli femër me dy të vegjël. Videoja është realizuar në rezervatin e gjuetisë të menaxhuar nga Eko Fazan. Kamerat kurth zbuluan gjithashtu një shumëllojshmëri të kafshëve të egra, ku kaprolli, gjahu kryesor i rrëqebullit, u vlerësua të ishte i bollshëm. Prandaj, baza solide e presë dhe prania e rrëqebullit të Ballkanit në këto zona do të thotë se kushtet janë të përshtatshme për të mbajtur një numër individësh të popullatës së rrëqebullit. Kjo gjithashtu do të thotë se rezervatet fqinje me zonën kryesore të rrëqebullit mund të ofrojnë mundësi lidhje dhe shpërndarje të llojit nga streha kryesore e tij - Parku Kombëtar i Mavrovës - për në zona të tjera që mund të strehojnë potencialisht rrëqebullin e Ballkanit.

Një zonë gjuetie e mirëmenaxhuar mund të mbështesë një popullatë të shëndetshme të llojeve objekt gjueti dhe grabitqarëve që janë në majë të zinxhirit ushqimor. Programi i Rimëkëmbjes së Rrëqebullit të Ballkanit pohon fuqishëm rolin e gjuetarëve në ruajtjen e rrëqebullit të Ballkanit, pasi ata janë gjithmonë në gatishmëri kur bëhet fjalë për mbrojtjen in-situ të tij. Ne duhet të sigurohemi që të ruhen raportet e mira dhe besimi i ndërsjellë, sepse ne kemi nevojë për të gjithë, nëse duam ta shohim këtë mace të shpëtuar dhe jo në prag të zhdukjes!

SI U FUT RRËQEBULLI I KORITNIKUT NË JETËN TIME TË PËRDITSHME

Nga Naim Palushi



“Quhem Naim Palushi dhe punoj si mësues në fshatin Zapod, njëri nga fshatrat shumë të thellë e malor të Kukësit. Jam i diplomuar për Gjuhë shqipe-letërsi dhe jap mësim në shkollën e mesme, në lëndët e profilit. Natyra është pasioni im. Shpesh jam pjesëmarrës i grumbullimeve të shoqërisë civile të biologëve dhe natyralistëve të zonës, ku flitet dhe diskutohet për zonat e mbrojtura dhe llojet endemike që janë drejt zhdukjes. Diskutime dhe debate të tilla për bimët endemike dhe kafshët akoma të pastudiuara dhe panjohura të shpateve të egra të shkrepace, janë objekte të bisedave që më bëjnë shumë entuziast. Informacionet e para për rrëqebullin dhe praninë e tij në zonë i kam patur nga biologu Arben Palushi (anëtar i rrjetit të monitorimit të rrëqebullit të Ballkanit, rajoni verior i Shqipërisë)

Një ndër debatet dhe ngjarjet natyrore që u bëra vetë dëshmitar ishte takimi im me rrëqebullin e Ballkanit. Duke ditur pasionin tim, mësuesit dhe nxënësit më thonin se në të dy shpatet e kanionit të Vanave, si atë të Koritnikut ashtu edhe të Gjallicës, është parë rrëqebulli dhe janë dëgjuar thirrjet e tij, sidomos gjatë 5-6 viteve të fundit.

Një fakt që e përforconte bindjen time më tepër për praninë e rrëqebullit në zonë, ishte dhe pohimi i kolegut Albert Muja, i cili këmbëngulte se ishte takuar me të dy herë në vitin e fundit, në një distancë të afërt. Kërkohej vetëm vërtetimi i fakteve dhe më në fund ai moment erdhi. Më datë 20 dhjetor, ora 7.20 e mëngjesit dhe rrëqebulli kalonte para furgonit të mësueve krenar, pa u trembur dhe me hap të sigurtë. Zbriti nga Gjallica, kaloi lumin dhe u ngjiti në Koritnik. Ky ishte moment! E kam njohur që në distancën 20 m dhe menjëherë ndalova furgonin. Dola ta dokumentoja ngjarjen së bashku me kolegun Muja, ku dhe e filmuam rrëqebullin. Kolegët më thonin me përsëritje që për mua është shfaqur, se unë nuk e besoja. Për më tepër se pesë minuta bënte paradë përpara nesh. Ishte shumë emocionues ai moment, shumë i gëzuar, sikur të kisha realizuar një objektiv të jashtëzakonshëm.

Rrëqebullin e kanë parë sërish, jo vetëm këtu. Ju kam thënë që sa herë ta shikoni apo t'i dëgjoni pasthirmën, më tregoni. Unë mendoj se është banor i përhershëm i këtyre habitateve.“

DUKE FESTUAR PËR MACEN TONË TË MADHE TË RREZIKUAR NË DITËN NDËRKOMBËTARE TË RRËQEBULLIT

Nga Andrej Gonev



© Hamlet Ahmedi

Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për biodiversitetin është një nga shtyllat kryesore në punën e mbrojtësve të natyrës. Përgjatë gjithë vitit, shumë ditë i janë dedikuar llojeve të ndryshme të rrezikuara dhe numri i këtyre ditëve vazhdon të rritet. Që nga viti 2018, Dita Ndërkombëtare e Rrëqebullit festohet çdo vit më 11 qershor për të theksuar rëndësinë e ruajtjes së maces më të madhe të Evropës dhe rolin e saj për një ekosistem sa më të shëndetshëm.

Puna për rritjen e vlerësimit të publikut ndaj këtij mishngrënësi të rrezikuar në mënyrë kritike që jeton në pyjet tona është thelbësore për mbijetesën e tij dhe ka qenë një nga prioritetet kryesore të Programit për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit. Këtë vit, MES dhe Parku Kombëtar i Mavrovës kanë bashkuar forcat dhe kanë sjellë tek brezi i ri temën mbi rrëqebullin duke organizuar një event edukativ në qendrën e informacionit në zemër të parkut të Mavrovës. Aktiviteti ishte i hapur edhe për anëtarët e MES, të cilët inkurajuan veçanërisht ata që kanë fëmijë, të vijnë dhe të bashkohen. Rreth njëqind fëmijë nga rajoni u shoqëruan nga mësuesit e tyre dhe patën rastin të mësojnë për rrëqebullin e Ballkanit përmes një

prezantimi të shkurtër dhe interesant që theksoi tiparet dhe rolin kryesor që luan kjo mace në ekosistem, si dhe rreziqet me të cilat përballet.

Nëpërmjet disa pyetjeve dhe diskutimeve, ata mësuan pse është e rëndësishme të mësosh të bashkëjetosh me ta. Pas prezantimit, ata përjetuan një eksperiencë të shkurtër se si është të jesh një rrëqebull në habitatin e tij natyror, duke ecur në një shteg pylli ku ishte instaluar një kamera kurth, ndërsa mbanin në fytyrat e tyre një maskë të frymëzuar nga rrëqebulli. Për ngazëllimin e tyre të madh, ata patën gjithashtu mundësinë të shihnin se si funksionon një kollare me GPS me një demonstrim lozonjar të fshehjes dhe kërkimit, ku dikush duhej të fshihej duke e vendosur atë dhe të tjerët përdornin një antenë-radio për t'i gjetur.

Aktivitete si këto janë vërtet të rëndësishme nëse duam ta afrojmë punën tonë me komunitetin lokal. Njohja më e madhe e njerëzve me metodat e monitorimit dhe aktivitetet e ruajtjes do të sjellë padyshim një pranim më të madh të tyre.

Përfshirja e brezave të rinj është thelbësore nëse duam të ngjallim admirimin dhe interesin e tyre për mbrojtjen e rrëqebullit të Ballkanit në të ardhmen.



© Ekrem Veapi

MORATORIUMI I RI I GJUE TISË NË SHQIPËRI: DO TË JETË I VËRTETË APO DO TË MBETET SËRISH NË LETËR?

Nga Aleksandër Trajçe

Qeveria shqiptare ka shtyrë së fundmi projektligjin për një moratorium të ri të gjuetisë në Shqipëri. Moratoriumi i ri propozohet edhe për pesë vite të tjera dhe do të vazhdojë sanksionimin e ndalimit të plotë të gjuetisë në Shqipëri pas dy moratoriemeve të mëparshme (2014-16 dhe 2016-21). Ndonëse në përshtypje të parë një vendim i tillë mund të duket si një vendim shumë i dobishëm për jetën e egër, realiteti është larg të qenit i tillë. Dy moratoriumet e mëparshme kanë qenë një katastrofë për sa i përket zbatimit të tyre në terren dhe kanë qenë vetëm vendime ‘të bukura’ për t’u treguar në letër. Me përjashtim të vetëm të vitit të parë (2014-15), vitet në vijim kanë shënuar një rritje dramatike të gjuetisë së paligjshme pothuajse në të gjithë territorin shqiptar dhe veçanërisht në zonat e thella ku ndikimi dhe shtrirja e institucioneve është më e dobët. Provat kanë treguar se metodat e ndryshme të vrasjes së kafshëve të egra, si kapja me kurthe, zënia në lak, helmimi, etj., janë rritur në mënyrë dramatike gjatë periudhës së moratoriumit. Një mori restorantesh në Tiranë dhe në fshatra kanë ofruar mishin e kafshëve të egra përgjatë gjithë periudhës së moratoriumit. Kërkesa e tyre po plotësohet nga një mori gjuetarësh të organizuar, të cilët gjuajnë dhe kapin një sërë llojesh pa marrë parasysh statusin e tyre të ruajtjes apo sa i rrallë është lloji.

Rrëqebulli i Ballkanit ka rënë viktimë e një praktike të tillë, me një rast të spikatur të një restoranti në Elbasan, i cili ka ekspozuar tre individë të rrëqebullit të Ballkanit në ambientet e tyre, dy me shumë mundësi të qëlluar në vitin 2017 dhe një i vrarë në vitin 2020. Moratoriumet kanë dhënë një justifikim për institucionet përgjegjëse që të mos zbatojnë asgjë në terren, duke u fshehur pas vendimit në letër dhe duke mos e ndjekur atë me patrullime dhe kontrole të situatës së gjuetisë në terren.



Reforma paralele e Inspektoratit të mjedisit dhe shërbimit pyjor ka lënë boshllëk për sa i përket inspektimit të institucioneve dhe përgjegjësive të tyre dhe është mjaft e paqartë se cili institucion është përgjegjës për të inspektuar situatën në terren, veçanërisht jashtë zonës së mbrojtur.

Ndërsa një nga synimet më të rëndësishme të dy moratoriemeve të para ishte përdorimi i asaj periudhe për të përmirësuar kuadrin ligjor të gjuetisë dhe për të forcuar institucionet menaxhuese, pothuajse asgjë nuk është realizuar në këtë drejtim. Nuk ka një ligj të ri për gjuetinë dhe një strategji të qartë për situatën afatgjatë të menaxhimit të jetës së egër në vend.

Në një situatë të tillë, PPNEA ka kundërshtuar zgjerimin e moratoriumit për pesë vite të tjera, duke nxitur përmirësimin e kuadrin ligjor për gjuetinë dhe menaxhimin e jetës së egër, si e vetmja zgjidhje afatgjatë për përfitimin dhe qëndrueshmërinë e faunës në vend. Ne kemi nxitur krijimin e Këshillit Kombëtar të Faunës, një institucion këshillimor pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për çështjet e menaxhimit të jetës së egër, i cili është krijuar në vitin 2021 dhe që mbledh së bashku shumë palë të interesuara për këtë çështje, përfshirë komunitetin e gjuetarëve, ruajtësve të natyrës e studiuesve dhe autoritetet përgjegjëse. Zgjidhja afatgjatë për menaxhimin e jetës së egër në vend mund të vijë vetëm përmes dialogut, mirëkuptimit dhe marrëveshjes së përbashkët të të gjitha palëve të interesuara dhe jo përmes qasjes apo vendimeve nga lart-poshtë si moratoriumet, të cilat janë të mira vetëm në letër, por ndërkohë i lënë gjuetarët e paligjshëm të pashqetësuar në natyrë.

PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

Balkan Lynx Recovery Programme (BLRP)

“Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit” (BLRP) është një iniciativë e përbashkët që implementohet nga Fondacioni EuroNatur, KORA (Shoqata e Ekologjisë së Mishngrënësve dhe Menaxhimi i Jetës së Egër në Zvicër), MES (Shoqëria Ekologjike Maqedonase), PPNEA (Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri) dhe ERA (Grupi i Veprimit me Përgjegjësi Mjedisore).

Informacion shtesë:

<https://www.facebook.com/balkanlynx>

Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit mbështetet financiarisht nga Fondacioni MAVA, me seli qendrore në Zvicër.



Environmentally
Responsible
Action



PPNEA

PROTECTION AND PRESERVATION OF NATURAL ENVIRONMENT IN ALBANIA
• SINCE 1991 •



MACEDONIAN
ECOLOGICAL
SOCIETY



Supported by:

euRONATUR

